



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar**

Nr. 3082 Prot.

Tiranë, më 10 . 6 . 2013



MIRATOHET

MINISTRI

MYQEREM TAJ

**KURRIKULA KOMBËTARE E ARSIMIT BAZË**

**PROGRAMI LËNDOR**

**LËNDA: QYTETARI**

**Klasa: 7-9**

**Tiranë, 2013**

**Grupi i punës:**

Artan FUGA

Mahir HOTI

Zyhdi DERVISHI 

Merita SHEME

Majlinda ZIU

Albana KOSOVRASTI

Aurora GUXHOLLI

Aida SERJANI Mirela KONDILI 

## 1. TË PËRGJITHSHME

Edukimi qytetar demokratik përmbledh në vetvete një tërësi konceptesh ose vlerash themelore që janë të përbashkëta për të gjithë demokracitë moderne. Të kuptuarit ashtu siç duhet i këtyre koncepteve, i vlerave dhe i marrëdhënieve ndërmjet tyre në kushtet e ndryshimeve të shpejta, si dhe të kuptuarit e problemeve që bartin, është kusht paraprak për një pjesëmarrje të efektshme dhe të përgjegjshme të qytetarëve në procesin e demokratizimit të realitetit. Ja disa nga këto koncepte:

- të drejtat e njeriut dhe liritë themelore (universaliteti, karakteri i pandashëm dhe i patjetërsueshëm i të drejtave dhe i lirive, i standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; legjislacioni ndërkombëtar i të drejtave të njeriut; të drejtat e trashëguara; institucionet dhe procedurat për zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut);
- demokracia (institucionet dhe procedurat; përfaqësimi dhe demokracia pjesëmarrëse; liritë demokratike) dhe parimet demokratike (përparësia e ligjit dhe e së drejtës, drejtësia shoqërore; barazia, pluralizmi; kohezioni shoqëror; përfshirja; mbrojtja e minoriteteve, solidariteti; paqja, stabiliteti dhe siguria);
- qytetaria (fuqizimi dhe përgjegjësia; pjesëmarrja aktive);
- shoqëria civile (parimet, institucionet dhe procedurat e një shoqërie civile; fuqizimi i shoqërisë civile; marrëdhëniet me shtetin);
- zhvillimi (ndryshime të qëndrueshme).

Forcimi dhe përsosja e demokracive, si në shoqëritë me demokraci të konsoliduara, ashtu dhe në demokracitë e reja, varet në një shkallë të konsiderueshme nga edukimi qytetar demokratik i anëtarëve të saj. Në këtë kontekst, edukimi i të rinjve me konceptet, parimet dhe praktikatat e demokracisë është me rëndësi të veçantë.

Nxënësit përgatiten të jetojnë si qytetarë të një shoqërie demokratike, pra duhet të dallojnë këtë formë qeverisjeje nga format e tjera. Nxënësit duhet të mësojnë se megjithëse parimet e demokracisë janë universale, zbatimi i tyre realizohet në përputhje me rrethanat konkrete të çdo shoqërie.

Sado të mira të jenë institucionet e demokracisë, sado të dëshirojnë njerëzit të jetojnë në demokraci, ajo nuk mund të funksionojë pa pjesëmarrjen e tyre aktive.

Programi “Qytetari” për klasat 7-9 u kushtohet problemeve, rolit dhe rrugëve të realizimit të pjesëmarrjes qytetare në demokraci. Ai ka për qëllim:

- t’u japë nxënësve njohuritë dhe t’u zhvillojë aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe në mënyrat e zbatimit të tyre;
- të zhvillojë aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të shkollës dhe të komunitetit;
- të zhvillojë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe të parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike;
- t’i aftësojë nxënësit në përcaktimin e kritereve për të gjykuar në mënyrë kritike se deri në çfarë mase qeveria e tyre vepron apo jo si një demokraci e vërtetë.

## 2. SYNIMET E PROGRAMIT SIPAS KLASAVE

### 2.1. SYNIMET E PROGRAMIT TË KLASËS SË 7-të

Qytetaria ka të bëjë me pjesëmarrjen në një komunitet politik. Qytetari në demokraci ka të drejtë dhe përgjegjësi për pjesëmarrjen në qeverisjen e vendit.

Programi i lëndës “Qytetari” për klasën e 7-të të arsimit nëntëvjeçar bazohet në standardet e lëndëve shoqërore dhe në ato të edukimit qytetar për arsimin e detyruar, kryesisht në linjat “**Dimensioni ligjor dhe i të drejtave të njeriut**” dhe “**Ideale dhe praktika të qytetarisë**”. Për këtë arsye, programi i klasës së shtatë synon të aftësojë nxënësit që si qytetarë:

- të jenë gjithmonë të mirinformuar për problemet politike, ekonomike, shoqërore të komunitetit ku jetojnë;
- të gjykojnë rreth tyre dhe të shprehin publikisht pikëpamjet e tyre;
- të marrin pjesë aktive në jetën shoqërore për ruajtjen dhe forcimin e demokracisë;
- të marrin pjesë, sipas moshës, në qeverisjen e shkollës e të komunitetit;
- të zbatojnë parimet dhe praktikat demokratike;
- të vlerësojnë rëndësinë e njohjes, të zbatimit dhe të përmirësimit të ligjit në funksion të mirëfunksionimit të demokracisë;

- të jenë modele të respektimit të të drejtave të njeriut në shoqërinë ku jetojnë.

## 2.2. SYNIMET E PROGRAMIT TË KLASËS SË 8-të

Programi i lëndës “Qytetari” për klasën e tetë të arsimit nëntëvjeçar bazohet në standardet e lëndëve shoqërore dhe në ato të edukimit qytetar për arsimin e detyruar, kryesisht në linjën “**Lidhjet globale**”.

Gjatë zhvillimit të kësaj lënde, nxënësit t’i jepet mundësia të zbulojë dhe të kuptojë të jetuarit në një botë të ndërvarur, të kuptojë se ai dhe të tjerët janë në marrëdhënie të kushtëzimit reciprok për të gjitha fushat e jetës. Ai duhet ta ndiejë veten si pjesë e një grupi, bashkësie, kombi, rajoni e bote, në marrëdhënie të ngushtë me mjedisin. Për këtë arsye ai duhet të shqyrtojë lidhjet që ekzistojnë ndërmjet bashkësive e vendeve dhe të dallojë e të kuptojë ndikimin që kanë (efekti domino) ngjarjet ose veprimet që ndodhin në rajone të ndryshme të vendit ose të botës me njëra-tjetrën.

Programi i klasës së tetë do të ndihmojë nxënësin të zbulojë, të shqyrtojë dhe të diskutojë pasojat pozitive ose negative të veprimeve të tij dhe të të tjerëve, të veprimeve të qeverisë dhe të organizatave ndërkombëtare e të shfaqë në veprime konkrete vetëdijen dhe përgjegjësinë e tij prej qytetari global për mjedisin ku jeton.

Lënda “Qytetari” e klasës së tetë duhet t’i shërbejë *zhvillimit të njohurive, të aftësive intelektuale dhe të prirjeve qytetare të nxënësve*. Nëpërmjet këtij programi synohet të aftësohen nxënësit:

- të kuptojnë se pikëpamja e tyre për botën formohet dhe kufizohet nga përvoja e tyre vetjake, si dhe nga kultura, klasa, kombësia, raca, gjinia, brezi ku bën pjesë etj. (Këndvështrime të kufizuara);
- të kuptojnë çështjet, prirjet dhe zhvillimet globale (Çështjet);
- të kuptojnë natyrën e ndërvarur dhe sistematike të botës (Ndërvarësia);
- të kuptojnë dhe të ndjejnë mendimet dhe ndjenjat e të tjerëve, veçanërisht të atyre që u përkasin kulturave, klasave, kombësive, racave, gjinive dhe brezave të ndryshëm (Empatia);

- të zhvillojnë shprehite e analizës kritike për të qenë të aftë të zbulojnë njëanshmëritë dhe për të formuar gjykimin e tyre për atë çfarë mësojnë nga media informative etj. dhe për atë që dëgjojnë në klasë (Shprehite kritike);
- të kuptojnë të përbashkëtat në nevoja, në talente dhe dëshira në të gjithë botën (E përbashkëta);
- të mësojnë si të përballen dhe të arrijnë të kontrollojnë fatin e tyre në një botë gjithnjë e në ndryshim (Shmangia e shokut psikologjik);
- të zhvillojnë dhe të praktikojnë shprehite e nevojshme për pjesëmarrje aktive dhe demokratike në bashkësinë e shkollës, të lagjes, të vendit dhe të bashkësisë botërore (Pjesëmarrja);
- të kuptojnë konceptin e ndryshimit, si dhe mjetet dhe rrugët për të ndikuar në të (Ndryshimi i botës);
- të vlerësojnë pasurinë kulturore që ofrojnë kulturat brenda dhe jashtë grupimeve shoqërore ku bëjnë pjesë (Pasuria kulturore);
- të zhvillojnë respektin e tyre për të drejtat, ndjenjat, vlerën dhe dinjitetin e qenieve njerëzore dhe qenieve të gjalla (Respekti);
- të kuptojnë dhe të provojnë në praktikë rëndësinë e bashkëpunimit dhe të zhvillojnë shprehite e duhura, si shprehite për shmangien dhe zgjidhjen e konflikteve (Bashkëpunimi);
- të zhvillojnë shprehite e duhura studimore, si: planifikimi, organizimi dhe ndjekja e hulumtimeve të pavarura, nxjerrja dhe vlerësimi i përfundimeve (Shprehite e studimit).

### **2.3 SYNIMET E PROGRAMIT TË KLASËS SË 9-të**

Forcimi dhe përsosja e demokracive, si në shoqëritë me demokraci të konsoliduara, ashtu dhe në demokracitë e reja, varet në një shkallë të konsiderueshme nga edukimi qytetar demokratik i anëtarëve të saj. Në këtë kontekst, edukimi i qytetarëve të rinj me konceptet, parimet dhe praktikatat e demokracisë është me rëndësi të veçantë.

Nxënësit përgatiten të jetojnë si qytetarë të një shoqërie demokratike, pra duhet të dallojnë këtë formë qeverisjeje nga format e tjera. Nxënësit duhet të mësojnë se megjithëse parimet e

demokracisë janë universale, zbatimi i tyre ndryshon në përputhje me rrethanat konkrete të çdo shoqërie.

Sado të mira të jenë institucionet e demokracisë, sado të dëshirojnë njerëzit të jetojnë në demokraci, ajo nuk mund të funksionojë pa pjesëmarrjen aktive të njerëzve.

Programi përfshin një kapitull të veçantë që u kushtohet problemeve, rolit dhe rrugëve të realizimit të pjesëmarrjes qytetare në demokraci.

Për nga tematika dhe mënyra e konceptimit, programi ofron mundësi që njohja e bazave të demokracisë, e vlerave dhe e shprehive të pjesëmarrjes qytetare, të realizohet në lidhje të ngushtë me përvojën jetësore të nxënësve dhe të komunitetit ku jetojnë.

Në mënyrë të veçantë, ky program synon t'u japë nxënësve njohuri për konceptet dhe parimet bazë të demokracisë e t'i aftësojë ata:

- të shpjegojnë organizimin dhe funksionimin e shtetit, si dhe lidhjet e pavarësinë ndërmjet pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- të analizojnë rolin e partive politike në zhvillimet aktuale shoqërore;
- të vlerësojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe plotësimin e detyrave qytetare, si kusht për zhvillimin e çdo komuniteti dhe forcimin e demokracisë;
- të identifikojnë dhe të denoncojnë raste të shkeljes së demokracisë në realitetin ku jetojnë;
- të vlerësojnë rolin e shoqërisë civile dhe të pjesëmarrjes qytetare për një qeverisje të drejtë dhe demokratike;
- të zotërojnë shprehitë e nevojshme qytetare për përmirësimin e jetës demokratike të shoqërisë;
- të shprehin kundërshtimet e tyre politike në rrugë paqësore dhe efektive;
- të zhvillojnë aftësitë vendimmarrëse;
- të përdorin burime të ndryshme informacioni për të marrë vendime të drejta, për të nxjerrë përfundime dhe për të vlerësuar veprime apo qëndrime.

### 3. KËRKESAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i lëndës “Qytetari” për klasat 7-9 zhvillohet në 35 javë, në një orë mësimore në javë. Pra, numri i orëve gjithsej në të cilat zhvillohet programi i lëndës “Edukimi qytetar” është 35, nga të cilat, rreth **21-24 orë (afërsisht 60%-70%)** janë në funksion të trajtimit të koncepteve të reja, ndërsa **11-14 orë (afërsisht 30%-40%)** shërbejnë për përpunimin e njohurive.

**Dokumentet dhe burimet bazë** që duhet të njihen paraprakisht për zbatimin efektiv të programit janë korniza kurrikulare, standardet e fushës dhe ato të lëndës, të gjitha programet e lëndës së edukimit qytetar për ciklin 1-9, programet e lëndëve të tjera, udhëzuesit lëndorë, manuallet e vlerësimit.

**Zbatimi** i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare etj.

**Objektivat** në programe përmbajnë njohuri, aftësi e qëndrime të karakterit të përgjithshëm, ndërnlëndor dhe lëndor.

Objektivat grupohen në linja e nënlinja dhe renditja e tyre mund të ndryshojë kur gjykohet e nevojshme nga zbatuesit e programit.

**Orët mësimore** sugjerohen në kuadrin e linjave dhe të nënlinjave, ndërsa ndarja e tyre në funksion të njohurive të reja dhe të përpunimit të njohurive bëhet në bazë të raportit të përcaktuar më sipër. Zbatuesit e programit kanë të drejtë të ndryshojnë numrin e orëve të sugjeruara për linjat në masën 10%.

#### **Përpunimi i njohurive përfshin:**

- përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive e të koncepteve themelore;
- integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera;
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja ose në njësi tematike, lënda duhet parë si një e tërë);
- testimin e njohurive bazë;
- testimin vjetor (ky testim nuk është i detyruar);



- projekte qytetarie në të cilët integrohen aftësitë kërkimore shkencore me grupimet e tjera të aftësive.

#### 4. INTEGRIMI DHE LIDHJA NDËRLËNDORE

Edukimi qytetar duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera. Lënda “Qytetari” dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet edhe objektivat kryesorë të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut.

Çfarë do të thotë kjo?

- Së pari, edukimi qytetar mund të shfrytëzojë informacione dhe çështje që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë idetë e veta.
- Së dyti, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin e edukimit qytetar për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë.

Shembuj:

##### a. Historia dhe Edukimi Qytetar

##### b. *Lënda e Historisë dhe ajo e Qytetarisë kanë të përbashkët:*

- Konceptet: për shembull pushteti, autoriteti, ligji, qeverisja, përfaqësimi, liria etj.
- Aftësitë dhe shprehjet: p.sh. përshkrimi, analiza, shpjegimi, diskutimi, kërkimi, interpretimi etj.

***Qytetaria:***

- u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret historia. Në këtë mënyrë, ai i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e historisë në jetën e tyre të përditshme.

***Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së Historisë dhe “Qytetarisë”?***

**Së pari**, kjo lidhje mund të realizohet përmes përfshirjes së çështjeve, të fakteve, të ngjarjeve etj. të trajtuara në lëndën e Historisë në kurrikulën e Qytetarisë, me kusht që përmasa e qytetarisë duhet:

- të jetë çështja thelbësore e mësimi;
- të lidhet me kurrikulën e edukimit qytetar.

**Së dyti**, objektivat mësimorë duhet të shprehen qartë dhe të jenë pjesë e kurrikulës kombëtare të edukimit qytetar. Kështu, lidhja ndërmjet tyre mund të realizohet përmes elementeve të mëposhtme:

- Konceptet: Karakteristikat e koncepteve (si drejtësia, barazia, liria etj.) duhet të shpjegohen në kohë dhe në hapësirë, pra në kontekste konkrete historike, në të kaluarën dhe në të sotmen.
- Tema: Në disa mësimë mund të theksohet përmasa e qytetarisë, si p.sh. në çështjet e të drejtave të njeriut.
- Fusha kurrikulare: Rishqyrtimi i vazhdueshëm i çështjeve të tilla, si demokracia etj., gjatë gjithë ciklit të shkollimit.
- Përmasa vendore: historia duhet të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën e bashkësisë, p.sh. duke ndërmarrë projekte ku mund të përfshihen breza të ndryshëm.

**Së treti**, historia ndihmon në edukimin qytetar kur ajo përdoret në debatet për çështje dhe ngjarje të rëndësishme.

**b. Gjeografia dhe Qytetaria**

***Çfarë kanë të përbashkët Gjeografia dhe Qytetaria? Ato kanë të përbashkët:***

- Konceptet: të drejtat e njeriut, bashkësia, ndërvarësia etj.
- Përmbajtjen: bota si bashkësi globale, sfidat e ndërvarësisë globale etj.
- Temat: strehimi, komunikimi etj.

***Si mund të ndihmojë lënda e Gjeografisë në trajtimin e çështjeve të lëndës “Qytetari”?***

- Ndhmon nxënësit të kuptojnë më mirë ndikimin e veprimtarisë ekonomike tek njerëzit dhe te bashkësia ku jetojnë.
- Nxjerr në pah marrëdhëniet ndërmjet zhvillimeve vendore, kombëtare dhe globale.
- Nxjerr në pah mundësinë e qytetarëve për të ndikuar në jetën e bashkësisë dhe më gjerë.
- Shqyrton në gjerësi dhe në thellësi çështje të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Nxit respektin për njerëz dhe kultura të tjera si dhe për mjedisin.

***Në ç’ mënyrë lënda “Qytetari” ndihmon në zhvillimin e lëndës së Gjeografisë?***

***Qytetaria:***

- Zbulon lidhjet e çështjeve me të cilat merret lënda e Gjeografisë me jetën e përditshme të nxënësve dhe rrit interesin e tyre për to.
- Ndhmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e lëndës së Gjeografisë.
- Nxit të kuptuarit e çështjeve që lidhen me zhvillimin, për shembull, tregtinë e ndershme.
- Nxit nxënësit të marrin pjesë në zhvillimin e projekteve të ndryshme në bashkësinë ku jetojnë, për shembull, për çështje mjedisore.

***Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së Gjeografisë dhe Qytetarisë?***

**Së pari**, mësimet e gjeografisë duhet të kenë si pjesë përbërëse përmasën e qytetarisë ose “prirjen qytetare”. Ato duhet të lidhen me konceptet e qytetarisë, si p.sh. me drejtësinë dhe të drejtat e njeriut, si dhe të përfshijnë veprimtari të tilla si diskutimet etj.

**Së dyti**, përmasa e qytetarisë gjatë zhvillimit të temave të edukimit qytetar duhet:

- të jetë çështja thelbësore e mësimi;
- të lidhet me kurrikulën e edukimit qytetar.

### **c. Fusha Shkenca natyrore dhe Qytetaria**

Shoqëria e sotme shtron vazhdimisht përpara nesh çështje që lidhen me jetën tonë si në plan vetjak, ashtu edhe në plan shoqëror. Trajtimi dhe zgjidhja e këtyre çështjeve, shpeshherë kërkon jo vetëm njohuri shkencore, por edhe aftësitë dhe shprehjet për t'u përfshirë në diskutime morale dhe veçanërisht për të bërë gjykime kritike.

#### ***Cilat janë të përbashkëtat ndërmjet fushës së Shkencave natyrore dhe Qytetarisë?***

- Dilemat etike, p.sh. a mund të përdoren kafshët për të bërë kërkime shkencore?
- Çështjet e ndryshme rreth shkencës dhe mjedisit, p.sh. çështja e ngrohjes globale.
- Ndikim i përparimeve teknike në shoqëri, p.sh. ndikim i internetit.
- Kontrolli i shkencës, p.sh. shpërndarja e fondeve për kërkime shkencore (do të përdorim miliarda lekë për të provuar që ka jetë në Mars apo do t'i përdorim këto lekë për qëllime të tjera më të rëndësishme për shoqërinë e sotme?).

#### ***Lënda “Qytetari” duhet të ndihmojë nxënësit që:***

- të reflektojnë dhe të diskutojnë për rrjedhojat shoqërore të zhvillimeve shkencore;
- të vlerësojnë rolin qendror të shkencës në botën e sotme;
- të kuptojnë karakterin kontradiktor të shkencës dhe faktin që shkencëtarët kanë pikëpamje të ndryshme dhe kundërshtuese si për faktet që përdoren në shkencë, ashtu edhe për rreziqet që rrjedhin prej zhvillimeve shkencore.

Autorët e teksteve dhe mësuesit, si përdoruesit kryesorë të programit të lëndës së Qytetarisë, duhet të përpiqen ose të kenë prirjen për të mbajtur parasysh mundësitë e lidhjes së kësaj lënde me lëndët e tjera. Realizimi në praktikë i kësaj lidhjeje jo vetëm do të ndihmonte në pasurimin e argumenteve të edukimit qytetar, por, duke ritheksuar lidhjen e edukimit qytetar me aspekte të ndryshme të realitetit, do të rriste edhe motivimin e tyre për këtë lëndë.

Mësuesit duhet të zgjedhin me kujdes pjesën nga kurrikula e shkencave të natyrës dhe të përcaktojnë jo vetëm objektivat e të nxënësve por edhe mënyrën për t'i zbatuar ato qartësisht të nxënësve. Këta të fundit duhet të kenë të qartë se po trajtojnë një çështje të edukimit qytetar.

## 5. METODOLOGJITË E MËSIMDHËNIES

Siç është vënë në dukje më sipër, edukimi qytetar demokratik përmbledh në vetvete një tërësi konceptesh ose vlerash themelore që janë të përbashkëta për të gjithë demokracitë moderne. Të kuptuarit ashtu siç duhet i këtyre koncepteve, i vlerave dhe i marrëdhënieve ndërmjet tyre dhe përdorimi si duhet i tyre varet shumë nga zhvillimi i aftësive qytetare të tilla si:

- të menduarit kritik: aftësia për të kërkuar, për të analizuar dhe për të zgjedhur informacione, duke shfrytëzuar njohuritë ndërlëndore, shprehitë e shumëfishta dhe qëndrimin kritik; aftësia për të marrë vendime mbi bazën e të dhënave dhe për të ndryshuar qëndrimet si rrjedhojë e argumenteve të vlefshme;
- të menduarit krijues: aftësia për të zbuluar mënyra të reja dhe të pazakonta, për të grupuar faktet në kuadrin e një procesi vendimmarrjeje, aftësia për të shmangur sa më shumë të jetë e mundur, përgjithësimet e tepruara, paragjykimet dhe stereotipat etj.;
- të menduarit e prirur drejt sjelljeve shoqërore dhe shoqërisë: aftësia për të analizuar faktet dhe problemet dhe për të bërë zgjedhje në interes të nevojave të të tjerëve dhe të shoqërisë në tërësi, duke luftuar egocentrizmin dhe etnocentrizmin; aftësia për të komunikuar me të tjerët dhe për të mësuar nga përvojat e ndryshme;
- të menduarit e drejtuar nga e ardhmja: aftësia për të identifikuar dhe për të kuptuar problemet dhe për të vlerësuar vendimet në dritën e përvojave dhe të së ardhmes së synuar.

Përveç të kuptuarit të koncepteve, të vlerave themelore dhe fitimit të aftësive themelore për një pjesëmarrje aktive dhe të përgjegjshme, për qytetarin janë të nevojshme edhe një tërësi qëndrimesh aktive shoqërore, të përcaktuara përgjithësisht në kuadrin e pjesëmarrjes dhe të përkushtimit ndaj vlerave të njohura e të pranuar si universale në shoqëri, si:

- përkushtimi ndaj parimit të universalitetit, të ndërvarësisë dhe të pandashmërisë të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore;
- bindja për vlerën, dinjitetin dhe lirinë e individit;
- përkushtimi ndaj shtetit të së drejtës, drejtësisë, barazisë dhe paanësisë;
- përkushtimi ndaj paqes dhe zgjidhjes pjesëmarrëse, paqësore dhe konstruktive të problemeve shoqërore;
- bindja për vlerën dhe domosdoshmërinë e parimeve, institucioneve dhe procedurave demokratike, si dhe për rëndësinë e veprimit qytetar;
- respektimi i kulturave të tjera dhe i ndihmesës së tyre për njerëzimin; pranimi i parimit të pluralizmit në jetën e përditshme;
- përkushtimi ndaj vlerës së mirëkuptimit të ndërsjellë, të bashkëpunimit, të mirëbesimit dhe të solidaritetit, si dhe ndaj luftës kundër racizmit, paragjyqimeve dhe çdo forme të diskriminimit;
- bindja në rëndësinë e përgjegjësisë dhe të përgjegjshmërisë personale;
- përkushtimi ndaj parimit të zhvillimit njerëzor të qëndrueshëm, që mban parasysht ekuilibrin ndërmjet zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor.

### **Disa parime metodologjike për zhvillimin e lëndës “Qytetari” në shkollë**

Edukimi qytetar është një proces që zgjat gjithë jetën. Si i tillë ai është proces i të nxënës social, domethënë është të nxënës *për, në dhe rreth* shoqërisë, në të njëjtën kohë është të nxënës për të jetuar së bashku. Ai nënkupton demokratizimin e të nxënës duke u përqendruar te nxënësi dhe në pavarësinë e përgjegjësinë e tij në procesin e të nxënës, duke nënkuptuar me këtë edhe bashkërendimin e procesit të të nxënës dhe të mësimdhënies.

*Edukimi qytetar arrihet nëpërmjet metodave të larmishme e të ndërlidhura të të nxënës, në të cilin ndërthuren lloje të tilla të edukimit si, p.sh. edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe, edukimi global, edukimi nëpërmjet medias etj.*

*Edukimi qytetar bazohet në përvojën dhe në praktikën vetjake. Si i tillë ai kërkon një kurrikulë të hapur që të përfshijë metodat pjesëmarrëse dhe ndërvepruese, të cilat bazohen në të nxënit nëpërmjet përvojës, veprimit dhe bashkëveprimit.*

*Pra, Edukimi qytetar synon të zëvendësojë format tradicionale të mësimdhënies dhe të të nxënit, në të cilat roli i mësuesit reduktohet në transmetimin e dijeve dhe të aftësive dhe ai i nxënësit në të dëgjuarit pasiv dhe, në rastin më të mirë, në përvetësimin e përmbajtjes së transmetuar. Edukimi qytetar nënkupton mundësitë e shumta të të mësuarit që ofron “shoqëria e të nxënit”.*

*Edukimi qytetar del përtej kufijve të shkollës dhe të komunitetit dhe sfidon ndarjen që ekziston ndërmjet edukimit formal dhe atij joformal, ndërmjet veprimtarive kurrikulare dhe atyre jashtëshkollore, si dhe ndërmjet shkollimit dhe shoqërizimit. Si i tillë, ai zhvillon karakterin e ndërsjellë të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit dhe nxit këmbimin e vazhdueshëm të rolit të mësuesve dhe të nxënësve. Në të njëjtën kohë, duke u përqendruar në fitimin e aftësive dhe të kompetencave të nevojshme për veprimin dhe ndryshimin shoqëror, edukimi qytetar ruan të gjitha karakteristikat e një përpjekjeje të paramenduar njerëzore që harmonizon teorizimet me diskutimin publik.*

*Në këtë kuadër, mësuesit duhet të shfaqen më tepër si organizatorë të mundësive të shumfishta të të mësuarit dhe si ura që lidhin burimet shoqërore me përdoruesit e tyre. Ata ndërmjetësojnë dhe lehtësojnë mundësinë e marrjes së informacionit dhe ndjekin në vazhdimësi sfidat e reja shoqërore, politike dhe teknologjike, si dhe nevojat gjithnjë e në rritje të nxënësve të tyre.*

*Nxënësit, gjithashtu, duhet të marrin pjesë aktivisht në vendimet lidhur me procesin edukativ, veçanërisht në ato që lidhen me përmbajtjen, metodat dhe strategjitë e mësimdhënies / të nxënit për qytetarinë demokratike. Mësimdhënia duhet të bëhet një proces ndërveprues, në të cilin jo vetëm diskutohen qëllimet arsimore, por edhe njihen e shkëmbehen kolektivisht përvojat e fituara.*

*Tërësia e procesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin, karakterizohet nga marrëdhënie të ndërsjella. Vlerësimi i dyfishtë dhe përdorimi i të dhënave cilësore për të matur rezultatet e të mësuarit ushtron ndikim të madh në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënit. Kjo praktikë bën që si mësuesit, edhe nxënësit të jenë të përgjegjshëm për veprimtarinë e tyre edukative dhe rezultatet e saj.*

## Çfarë kërkohet nga mësuesi i lëndës së “Qytetarisë”?

Rolet dhe kompetencat që mësuesit dhe nxënësit kanë pasur tradicionalisht sot kanë pësuar ndryshime. Disa nga ndryshimet që kanë ndodhur në kompetencat tradicionale të mësuesve lidhen me:

- dijet e integruara ndërlëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të veçanta në: lëndët mësimore, teoritë dhe çështjet që lidhen me natyrën dhe zhvillimin njerëzor, përshtatjen e teorive të ndryshme të të mësuarit për arritjen e synimeve të veçanta edukative, (në fushën e sjelljes, të njohurive dhe të humanizmit), parimet e procesit të mësimdhënies / të të nxënit, organizimin dhe administrimin e veprimtarive në grup;
- procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundrejt procesit linear dhe statik të saj në të gjitha përmasat e tij: a) në përpunimin dhe përcaktimin e objektivave të larmishëm; b) në administrimin e zhdërvjellët të orëve të mësimit dhe të grupeve; c) në shumëllojshmërinë e modeleve të mësimdhënies përmes të mësuarit të hapur dhe në bashkëpunim; d) në vlerësimin e ndërsjellë;
- synimet edukative të shumëfishta përkundrejt atyre të kufizuara në fushën e njohurive. Të parat marrin parasysh kompleksitetin dhe ndryshimet që ndodhin në botën e sotme dhe mbështeten në angazhimin individual për të përmirësuar kushtet e jetës dhe për të zotëruar shprehitë e nevojshme për veprim.
- Një prej kërkesave më të rëndësishme në fushën e mësimdhënies është bindja e mësuesit në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe që ai vetë është i aftë t’i mësojë ose t’i ndihmojë për të mësuar. Të mësuarit për qytetarinë demokratike përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimit të nxënësve për t’u bërë qytetarë të përgjegjshëm:
- aftësia për t’i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tija;
- aftësia për të kuptuar, për të pranuar dhe për të respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve, si dhe ndërmjet nxënësve;
- respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;



- aftësia për të trajtuar çështje kontradiktore dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
- aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;
- aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;
- gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësim prej tyre;
- aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuara nga kurrikula e fshehtë.

### **Kërkesa të veçanta për mësuesit për zbatimin e programit të lëndës “Qytetari” të klasës së tetë**

Nga mësuesi kërkohet:

- të ndiejë veten si qytetar të botës, të kuptuar në ndërvlerësinë dhe kushtëzimin e saj, dhe të ndihmojë nxënësit të hulumtojnë në gjendjen e sotme globale, duke nxitur mbajtjen e qëndrimit të tij për çështjet aktuale globale dhe argumentet rreth tyre;
- të interesohet rreth kulturës të së ardhmes dhe të përpiqet të zhvillojë te nxënësit shkallën e të kuptuarit të kulturës përtej bashkësisë ku bën pjesë; t'i nxisë nxënësit të vlerësojnë dhe të pranojnë diversitetin dhe të bëhen të ndjeshëm e të hapur ndaj pikëpamjeve dhe qëndrimeve të tjera për botën;
- të orientohet gjithmonë nga e ardhmja, të ndihmojë nxënësit të mbajnë qëndrim për të ardhmen e tyre dhe të edukojë te ta shprehitë dhe aftësitë e duhura për pjesëmarrje në proceset politike e sociale të shoqërisë;
- të lehtësojë procesin e të nxënësve dhe të përpiqet të fitojë aftësitë e nevojshme për rolin e tij si lehtësues;
- të ketë besim në mundësitë e nxënësve, të besojë se edhe ata janë qenie njerëzore me ide dhe përvoja që mund t'i ndajnë me të tjerët, pra dhe me të, dhe t'ua krijojë atyre këtë mundësi;
- të përdorë larmi të madhe teknikash e stilesh mësimore dhe të bëjë kujdes që nxënësit të ndihen mirë dhe të sigurt në klasë;

- të vlerësojë të nxënit si një proces që zgjat gjatë gjithë jetës dhe t'i nxisë nxënësit të bëjnë kujdes që të mos përpiqen të ofrojnë gjithnjë përgjigje përfundimtare;
- të respektojë të drejtat e njeriut dhe të punojë që nxënësit në mënyrë të pavarur të ushtrojnë aftësitë e tyre të gjithanshme në një mjedis demokratik dhe pjesëmarrës;
- të kërkojë gjithmonë lidhjen ndërlëndore, funksionale në kurrikulën shkollore dhe të përpiqet të harmonizojë synimet, objektivat dhe strategjitë e të mësuarit dhe të vlerësimit gjatë gjithë zbatimit të kurrikulës.

### **Mjedisi i të nxënit për qytetari demokratike**

Edukimi qytetar nxit dhe nxitet nga një mjedis të nxëni demokratik në shkollë dhe nga një metodë që synon të përfshijë të gjithë shkollën, nga metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit dhe nga pjesëmarrja e nxënësve, e stafit arsimor, e prindërve në marrjen e vendimit dhe sa më shumë të jetë e mundur në kurrikulën e arsimit formal dhe joformal.

Ai kërkon që nxënësit të njihen dhe të pranohen si subjekte të drejtash, nga njëra anë, dhe si bartës të drejtash, nga ana tjetër.

Edukimi qytetar zgjerohet dhe mbështetet nga bashkëveprimi krijues ndërmjet institucioneve arsimore dhe të komunitetit, duke nënkuptuar edhe bashkëveprimin ndërmjet të nxënit formal dhe joformal. Si i tillë ai kërkon mbështetjen e duhur ligjore dhe financiare për zhvillime autonome në të gjitha nivelet.

Edukimi qytetar duhet të zhvillohet:

- duke vendosur partneritete ndërmjet aktorëve në edukimin për qytetari demokratike, duke vlerësuar pozitivisht kulturat dhe mënyrën e jetesës demokratike të rinisë, vetëshprehjen dhe aspiratat e nxënësve dhe të të rinjve për t'u dëgjuar, duke e shndërruar këtë në bazë të edukimit për qytetari demokratike;
- duke ndërmarrë kërkime që kanë në bazë pjesëmarrjen dhe zbatimin në praktikë të nismave dhe risive në fushën e edukimit për qytetari demokratike, për trajnimin dhe zhvillimin e kurrikulave;
- duke nxitur informimin për përdorimin e teknologjive të komunikimit në fushën e arsimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë vlerësimit përzgjedhës mes kriterëve të

informacionit dhe mbështetjes së nismave të së drejtës për të shfrytëzuar IKT në fushën e edukimit për qytetari demokratike;

- duke zhvilluar vetëdijen dhe praktikën e mishërimit të përgjegjesisë shoqërore.

## 6. METODAT E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE

Standardet e përmbajtjes së lëndës së Qytetarisë përfshijnë tri elemente të ndërlidhura me njëra-tjetrën: njohuritë, aftësitë intelektuale e ato të pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare. Të marra së bashku, këto elemente përbëjnë bazën për zhvillimin e edukimit qytetar dhe, për rrjedhojë, edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve duhet të pasqyrojë nevojën për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të këtyre tri elementeve nga nxënësit.

*Njohuritë* përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetjet ose në kërkesa të tilla si:

- Cilat janë vlerat që qëndrojnë në themel të ligjit?
- Përshkruaj cilat janë hapat nëpër të cilët kalon procesi i hartimit dhe i miratimit të ligjit.
- Identifiko në kushtetutën tonë nenet që flasin për të drejtat e njeriut etj.

*Aftësitë intelektuale dhe ato pjesëmarrëse* të edukimit qytetar përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e zgjidhur sfidat e jetës demokratike në vend.

Aftësitë intelektuale aftësojnë nxënësit që të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë nxënësit të identifikojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet, si dhe të vlerësojnë, marrin dhe mbrojnë qëndrime të caktuara për çështje të jetës publike.

*Aftësitë pjesëmarrëse* aftësojnë qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë në jetën publike dhe atë qytetare, duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe shprehur qartë idetë dhe interesat e tyre, duke bërë koalicione, duke kërkuar konsensus, duke bërë marrëveshje dhe duke menaxhuar konfliktet.

Një vlerësim tërësor në lëndën e Edukimit qytetar nënkupton edhe vlerësimin, në atë shkallë që kjo është e mundur, e aftësive pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë edhe *matjen e shkallës në të cilën nxënësit kuptojnë përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse. Këtu duhet të sqarohet se, në këtë vlerësim, nuk përfshihet matja e drejtpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike.*

Elementi i tretë janë *prirjet qytetare*, të cilat përshkojnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve e të praktikave të qytetarisë demokratike.

Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë anëtar i pavarur i shoqërisë,
- për të respektuar vlerat individuale dhe dinjitetin njerëzor,
- për të marrë përsipër përgjegjësitë personale, politike dhe ekonomike të qytetarit,
- për t'iu bindur “rregullave të lojës” së demokracisë, si pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimi i të drejtave të minoriteteve,
- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirinformuar, të arsyeshme dhe të efektshme,
- për të nxitur dhe për të mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve duhet të përqendrohet *në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë. Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet personale të nxënësve të vlerësuar.*

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare duhet të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale. Për shembull, nxënësit mund t'i kërkohet të përshkruajë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinionëve të të tjerëve. *Po kështu, nxënësit mund t'i matet aftësia për të vëzhguar dhe për të zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose të institucioneve qeverisëse me parimet kushtetuese.*

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kontekste të ndryshme, si shtëpi, shkollë, bashkësi, shtet, rajon e më gjerë. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë, por edhe zbatohen në praktikë.

## 7. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE / NËNLINJAVE

**KLASA 7**  
**35 javë x 1 orë/javë = 35 orë**

**LINJA: PJESËMARRJA QYTETARE SI KUSHT PËR FUNKSIONIMIN E QYTETARISË**

**Orë të sugjeruara: 10 orë**

**Përshkrimi i përmbajtjes së linjës:**

Shoqëria civile është karakteristikë e demokracisë. Ajo ka të bëjë me veprimin e pavarur dhe vullnetar të individëve ose të grupeve, jashtë institucioneve shtetërore dhe detyrimit ligjor.

Nxënësit duhet të përgatiten për pjesëmarrje aktive në shoqërinë civile, duke e konsideruar këtë si kusht për ruajtjen dhe forcimin e demokracisë. Pjesëmarrja qytetare në qeverisje është tipar dhe kusht i demokracisë.

Për të mbrojtur liritë dhe për të siguruar interesat e tyre, qytetarët duhet të marrin pjesë në qeverisje. Për të qenë pjesëmarrës aktivë në proceset demokratike, nxënësit duhet të njohin dhe të ushtrjnë parimet dhe praktikatat demokratike.

Linja	Objektivat	Konceptet kyçe
Pjesëmarrja qytetare si kusht për funksionimin e qytetarisë	<p><b>Gjatë realizimit të kësaj linje, nxënësit duhet të aftësohen:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të përshkruajnë konceptin qytetari, pjesëmarrje qytetare dhe shoqëri civile;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Qytetari</li> <li>Pjesëmarrje</li> <li>Përgjegjësi</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajnë dhe të ilustrojnë format e pjesëmarrjes qytetare;</li> <li>• të identifikojnë veprimin e parimeve themelore të qeverisjes demokratike në jetën e komunitetit në qytetin dhe vendin tonë;       <ul style="list-style-type: none"> <li>- të analizojnë ndikimin e formave të ndryshme të opinionit shoqëror në veprimtarinë e qeverisë;</li> <li>- të marrin pjesë në diskutime publike në klasë, në shkollë ose në komunitet.</li> </ul> </li> <li>• të analizojnë përgjegjësitë e qeverisë ndaj qytetarëve dhe anasjelltas;       <ul style="list-style-type: none"> <li>- të vlerësojnë mënyrat me anë të të cilave qytetarët mund të ndikojnë për ndryshime pozitive në qeverisje.</li> </ul> </li> <li>• të shpjegojnë ndikimin e veprimit qytetar në formulimin e politikave publike dhe marrjen e vendimeve;       <ul style="list-style-type: none"> <li>- të shpjegojnë rolet e qytetarit në një shoqëri demokratike;</li> <li>- të demonstrojnë aftësi komunikimi në grup, në marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e konflikteve me mjete demokratike;</li> <li>- të demonstrojnë përkushtim ndaj së mirës së përgjithshme.</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Parime demokratike</li> <li>• Komunitete</li> <li>• Politikë publike</li> <li>• Marrje vendimi</li> <li>• Përkushtim</li> </ul>
--	---	--

## LINJA: RREGULLAT, LIGJI DHE ROLI I TYRE NË SHOQËRI

**Orë të sugjeruara: 10**

### Përshkrimi i linjës

Nxënësit duhet të vlerësojnë rëndësinë e veprimit të ligjit, të rregullave dhe zakoneve në shoqëri, të analizojnë burimet, qëllimet dhe funksionet e ligjit dhe të mbajnë qëndrim në mbrojtje të ligjeve. Ligjet dhe rregullat nuk janë të dhëna njëherë e përgjithmonë. Ato ndryshojnë nën ndikimin e faktorëve politikë, ekonomikë dhe socialë.

Karakteristikë e demokracisë është përmirësimi i vazhdueshëm i ligjeve dhe pjesëmarrja e gjerë e qytetarëve në procesin e hartimit dhe zbatimit të tyre. Nxënësit duhet të jenë të aftë të shpjegojnë kush i bën ligjet, procedurat e hartimit dhe rrugët që sigurojnë zbatimin e tyre.

Linja	Objektivat	Konceptet kyçe
<b>Rregullat, ligji dhe roli i tyre në shoqëri</b>	<p><b>Gjatë realizimit të kësaj linje, nxënësit duhet të aftësohen:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajnë përmbajtjen e koncepteve; ligje rregulla dhe zakon;</li> <li>• të bëjnë dallimin ndërmjet ligjeve dhe normave morale;</li> <li>• të analizojnë vlerat (morale, politike e shoqërore etj.) që shërbejnë si burim për ligjet;</li> <li>• të vëzhgojnë ndikimin e ligjeve dhe të rregullave në familje, shkollë dhe komunitet;</li> <li>• të shpjegojnë ndikimin e ligjit në jetën personale dhe shoqërore;</li> <li>• të vlerësojnë rolin e gjykatave, të policisë dhe të qytetarëve në zbatimin e ligjit;</li> <li>• të analizojnë faktorët që çojnë në ndryshimin e ligjit;</li> <li>• të përshkruajnë procedurat për përcaktimin e ligjit;             <ul style="list-style-type: none"> <li>- të përshkruajnë procedurat e hartimit dhe të</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rregull</li> <li>• Moral</li> <li>• Normë morale</li> <li>• Zakon</li> <li>• Ligj</li>   <li>• Vlera të ligjeve</li> <li>• Gjykatë</li> <li>• Polici</li> <li>• Ligjvënës</li> <li>• Zbatim ligji</li> </ul>

	<p>zbatimit të disa lloje ligjesh;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të tregojnë procedurat e hartimit të rregullores së shkollës;</li> <li>• të marrin pjesë në diskutimin dhe formulimin e rregullave në shkollë, familje dhe komunitet;</li> <li>• të vlerësojnë ndikimin e rregullave e ligjeve të shkollës në ushtrimin e të drejtave dhe të përgjegjësive të nxënësve;</li> <li>• të diskutojnë për faktorët që ndikojnë në zbatimin e ligjit dhe të rregullave.</li> </ul>	
<p><b>LINJA: TË DREJTAT, PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT QYTETARE</b></p> <p><b>Orë të sugjeruara: 15</b></p>		
<p><b>Përshkrimi i linjës</b></p> <p>Në një shoqëri demokratike, detyrë kryesore e qeverisë është mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të individit. Por, sado i përsosur të jetë shteti, këto liri dhe të drejta nuk garantojnë në qoftë se qytetarët nuk janë të ndërgjegjësuar për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre dhe nuk veprojnë individualisht apo në grup për t'i mbrojtur ato.</p> <p>Në këtë kontekst, nxënësit duhet të njohin kategoritë e të drejtave, lidhjet e tyre me detyrat, përgjegjësitë dhe format e veprimit qytetar në mbrojtje të të drejtave.</p>		
Linja	Objektivat	Konceptet kyçe
<p><b>Nënlinja:</b></p> <p><b>Të drejtat</b></p>	<p><b>Gjatë realizimit të kësaj linje, nxënësit duhet të aftësohen:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të dallojnë e të përshkruajnë përmbajtjen e të drejtave të njeriut;</li> <li>• të tregojnë nga burojnë të drejtat e njeriut;</li> <li>• të listojnë dokumentet kryesore ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e njeriut, si: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Deklaratën e përgjithshme të të drejtave të njeriut;</li> <li>- Ligjin kushtetues “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”;</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nevoja</li> <li>• Dëshira</li> <li>• Të drejta themelore</li> <li>• Burim i të drejtave</li> <li>• Zbatim i të drejtave</li> <li>• Konventë</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Konventën për të drejtat e fëmijës;</li> <li>- Konventën evropiane për të drejtat e njeriut;</li> <li>• të shpjegojnë rëndësinë individuale dhe shoqërore të të drejtave personale, ekonomike dhe politike, si dhe lidhjen ndërmjet tyre: <ul style="list-style-type: none"> <li>- të dallojnë të drejtat e fëmijës në legjislacion;</li> <li>- të dallojnë parimet themelore të Konventës për të drejtat e fëmijës;</li> <li>- të përshkruajnë të drejtat e pakicave etj.</li> </ul> </li> <li>• të vëzhgojnë zbatimin e të drejtave të fëmijës: <ul style="list-style-type: none"> <li>- të grumbullojnë të dhëna nga shtypi, të organizojnë diskutime, të shkruajnë letra, të përfshihen në veprimtari shoqërore etj.</li> </ul> </li> <li>• të analizojnë dhe të vlerësojnë problemin e të drejtave të njeriut në komunitetin ku bëjnë pjesë (familje, shkollë, në komunitetin lokal etj.).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vëzhgim i zbatimit të të drejtave</li> </ul>
<p><b>Nënlinja</b> <b>Përgjegjësitë</b></p>	<p><b>Në fund të kësaj linje nxënësit duhet të aftësohen:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të dallojnë përgjegjësinë personale nga ajo shoqërore;</li> <li>• të shpjegojnë se cilat janë përgjegjësitë qytetare:</li> </ul> <p><b><i>Përgjegjësitë personale</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kujdesi për veten,</li> <li>- kujdesi për familjen,</li> <li>- të qenit i përgjegjshëm për veprimet që kryen,</li> <li>- respektimi i të drejtave të të tjerëve,</li> <li>- respektimi i vlerave morale.</li> </ul> <p><b><i>Përgjegjësitë shoqërore</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbatimi i ligjeve,</li> <li>- pagimi i taksave,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgjegjësi</li> <li>• Përgjegjësi personale</li> <li>• Përgjegjësi shoqërore</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- kontributi për të mirën e përgjithshme,</li> <li>- respektimi i të drejtave të të tjerëve,</li> <li>- votimi,</li> <li>- marrja e informacionit për problemet publike,</li> <li>- pjesëmarrja në zgjidhjen e problemeve publike.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të kategorizojnë përgjegjësitë e tyre personale dhe shoqërore në komunitet;</li> <li>• të analizojnë burimet e përgjegjësisë;</li> <li>• të vlerësojnë rëndësinë individuale dhe shoqërore të plotësisimit të përgjegjësisë dhe të analizojnë shkaqet dhe pasojat në rast mosplotësimi;</li> <li>• të evidentojnë nga jeta e përditshme problemet që lidhen me përgjegjësitë qytetare dhe të zgjedhin qëndrimin e tyre.</li> </ul>	
<p><b>Nënlinja:</b> <b>Detyrat</b> <b>qytetare</b></p>	<p><b>Në fund të kësaj linje nxënësit duhet të aftësohen:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajnë detyrat e qytetarëve, për shembull: detyra morale ndaj tjetrit dhe shoqërisë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- besnikëria ndaj atdheut,</li> <li>- respekti për të tjerët,</li> <li>- respektimi i njerëzve të zgjedhur etj.</li> </ul> </li> <li>detyra ndaj vetes: <ul style="list-style-type: none"> <li>- arsimimi etj.</li> </ul> </li> <li>detyra ndaj shoqërisë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- pjesëmarrja në votime,</li> <li>- respektimi i tjetrit,</li> <li>- respektimi i ligjit,</li> <li>- pjesëmarrja në qeverisje,</li> <li>- kritika ndaj njerëzve të zgjedhur etj.</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Besnikëri ndaj atdheut,</li> <li>• Respekti për të tjerët,</li> <li>• Respektimi i njerëzve të zgjedhur</li> <li>• Kritika ndaj njerëzve të zgjedhur</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të dallojnë ligjet dhe institucionet që garantojnë realizimin e detyrave qytetare;</li> <li>• të analizojnë dhe të vlerësojnë raste nga jeta e përditshme që lidhen me realizimin ose jo të detyrave qytetare;</li> <li>• të evidentojnë nga jeta e përditshme problemet që lidhen me përgjegjësitë qytetare dhe të zgjedhin qëndrimin e tyre;</li> <li>• të vlerësojnë detyrat e tyre individuale dhe shoqërore;</li> <li>• të zbatojnë njohuritë duke ndërmarrë veprime konkrete (individuale ose në grup) për zbatimin e detyrave qytetare.</li> </ul>	
--	--	--

## KLASA 8

**35 javë x 1 orë/javë = 35 orë**

**LINJA: UNË DHE TË TJERËT**

**Orë të sugjeruara: 8 orë**

**Përshkrimi i përmbajtjes së linjës:**

Në këtë linjë nxënësit fillojnë të eksplorojnë konceptin e ndërvarësisë duke filluar nga gjërat përreth tyre, me të cilat ata janë të familjarizuar. Ata fillojnë të shohin veten në kuadrin e lidhjeve më të gjera dhe të kuptojnë se jeta e tyre është e kushtëzuar prej këtyre lidhjeve, ndërkohë që ata vetë kushtëzojnë të tjerë. Ata mësojnë të vlerësojnë të kaluarën dhe të kuptojnë se e ardhmja e tyre nuk është diçka që rrjedh vetvetiu, por është produkt i bashkëveprimit njerëzor, i cili, për këtë arsye, duhet të bëhet më i vetëdijshëm e largpamës

Linja	Objektivat	Konceptet kyçe
Unë dhe të tjerët	<p><b>Gjatë realizimit të kësaj linje, nxënësit duhet të aftësohen:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të tregojnë që njerëzit ndryshojnë nga njëri-tjetri në drejtime të ndryshme, por ata ndajnë shumë gjëra të përbashkëta;</li> <li>• të tregojnë që gjërat e përbashkëta që ata kanë me moshatarët e tyre janë shumë më të rëndësishme se dallimet;</li> <li>• të identifikojnë disa nga interesat e përbashkëta që kanë me moshatarët e tyre të klasës ose të lagjes, pavarësisht nga ndryshimet që kanë;</li> <li>• të identifikojnë sfidat e ngjashme me te cilat duhet të përballen gjatë jetës së tyre rinore (shkolla, argëtimi, e ardhmja etj.);</li> <li>• të përshkruajnë mundësitë dhe kufizimet e tyre në plan individual për plotësimin e interesave e ëndrrave të tyre dhe nevojën që ata kanë për të tjerët;</li> <li>• të përshkruajnë dhe të shpjegojnë se si njerëzit kanë nevojë për njëri-tjetrin në nivelin <ul style="list-style-type: none"> <li>○ vetjak,</li> <li>○ familjar,</li> <li>○ e grupit shoqëror</li> <li>○ e lagjes etj.</li> </ul> </li> <li>• të përshkruajnë si kanë ndryshuar këto marrëdhënie ndërvarësie gjatë jetës së tyre;</li> <li>• të parashikojnë mundësinë e ndërvarësisë në të ardhmen, duke u bazuar në studimin e së kaluarës dhe në zbulimin e prirjeve të sotme;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I ndryshëm</li> <li>• I barabartë</li> <li>• Prirje</li> <li>• E kaluara</li> <li>• E sotmja</li> <li>• E ardhme e dëshiruar</li> <li>• Kushtëzim i ndërsjellë</li> <li>• Ndërvarësi</li> <li>• Mundësi të kufizuara</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>të tregojnë çfarë mund të bëjnë ata sot në mënyrë që të sjellin të ardhmen e dëshiruar ose të frenojnë të ardhmen e padëshiruar.</li> </ul>	
--	--	--

**LINJA: NE DHE EVROPA**

**Orë të sugjeruara: 6 orë**

**Përshkrimi i linjës**

Në këtë linjë nxënësit vijojnë me eksplorimin e tipareve të përbashkëta dhe dalluese të shqiptarëve dhe të Evropës. Ata mësojnë të vlerësojnë kulturën dhe traditën kulturore të Shqipërisë, ndërkohë që respektojnë realisht edhe kulturën dhe traditat kulturore të Evropës. Ata fillojnë të mendojnë si qytetarë të Evropës, pjesë e së cilës do të jenë realisht së shpejti.

Linja	Objektivat	Konceptet kyçe
<b>Ne dhe Evropa</b>	<p><b>Gjatë realizimit të kësaj linje, nxënësit duhet të aftësohen:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të dallojnë tiparet e identitetit evropian (eksplorimi i Evropës): <ul style="list-style-type: none"> <li>të identifikojnë disa nga veçoritë që mendojnë se i takojnë qytetarit evropian;</li> <li>të eksplorojnë disa nga fushat kryesore të jetës në Evropë, si: kultura, muzika, veshja, mjedisi etj.;</li> <li>të përshkruajnë disa nga tiparet e njohura të fqinjëve tanë.</li> </ul> </li> <li>të dallojnë dhe të përshkruajnë tipare, ide, qëndrime që janë të veçanta për kulturën tonë, krahasuar me ato të kulturave të tjera: <ul style="list-style-type: none"> <li>të përshkruajnë veten e tyre si qytetarë të Shqipërisë;</li> <li>të përshkruajnë veten e tyre si qytetarë të Evropës.</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Diversitet</li> <li>Ngjashmëri</li> <li>Të barabartë</li> <li>Shqiptar</li> <li>Evropian</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajnë me shembuj anët pozitive dhe negative të të qenit vetëm shqiptar;</li> <li>• të shpjegojnë se respekti i ndërsjellë dhe bashkëpunimi janë të domosdoshëm për bashkëjetesë paqësore në një botë gjithnjë e më të ndërvarur.</li> </ul>	
<p><b>LINJA: SHQIPËRIA DHE EVROPA</b></p> <p><b>Orë të sugjeruara: 12 orë</b></p>		
<p><b>Përshkrimi i linjës</b></p> <p>Gjatë realizimit të kësaj linje, nxënësit duhet të aftësohen të përshkruajnë rolin dhe qëllimet themelore të organizmave të tillë evropianë si: Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian dhe të tregojnë ndikimin pozitiv ose negativ të bashkëpunimit të Shqipërisë me Evropën ose me gjerë, në jetën e individit, të familjes, të ekonomisë dhe të kombit shqiptar.</p>		
Linja	Objektiva	Konceptet kyçe
<p><b>Shqipëria dhe Evropa</b></p>	<p><b>Gjatë realizimit të kësaj linje, nxënësit duhet të aftësohen:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajnë rolin dhe qëllimet themelore të organizmave të tillë evropianë si: Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian etj.;</li> <li>• të flasin, duke përdorur shembuj, për rëndësinë e bashkëpunimit të vendit tonë me Evropën e organizmat e saj: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ në fushën kulturore,</li> <li>○ në fushën ekonomike,</li> <li>○ në fushën arsimore,</li> <li>○ në fushën shtetërore,</li> <li>○ në fushën ligjore.</li> </ul> </li> <li>• të tregojnë, duke përdorur shembuj të ndryshëm, ndikimin pozitiv ose negativ të bashkëpunimit të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Organizëm evropian</li> <li>• Këshilli i Evropës</li> <li>• Bashkimi Evropian</li> <li>• Bashkëpunim kulturor</li> <li>• Bashkëpunim ligjor</li> <li>• Bashkëpunim politik</li> <li>• Bashkëpunim arsimor</li> <li>• Ndikim pozitiv</li> </ul>

	<p>Shqipërisë me Evropën ose me gjerë, në jetën e individit, të familjes, të ekonomisë dhe të kombit shqiptar;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të shprehin mendimin e tyre për forma ose nivele bashkëpunimi që të jenë në interes të ndërsjellë të Evropës dhe të Shqipërisë e të shqiptarëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikim negativ</li> </ul>
<p><b>LINJA: NE DHE PROBLEMET GLOBALE</b></p> <p><b>Orë të sugjeruara: 9 orë</b></p>		
<p><b>Përshkrimi i linjës</b></p> <p>Nëpërmjet kësaj linje nxënësit nxiten të mendojnë e të interesohen për problemet e mprehta globale, të cilat shfaqen edhe në vendin tonë.</p> <p>Ata analizojnë shkaqet dhe pasojat e këtyre problemeve në Shqipëri dhe shfaqin përgjegjësinë e tyre qytetare në vlerësimin e politikës vendore dhe shtetërore lidhur me zgjidhjen e tyre. Në të njëjtën kohë nxiten të veprojnë në komunitetin ku jetojnë për eliminimin e shkaqeve të tyre.</p>		
Linja	Objektivat	Konceptet kyç
<p><b>Ne dhe problemet globale</b></p>	<p><b>Gjatë realizimit të kësaj linje, nxënësit duhet të aftësohen:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të evidentojnë format e shfaqjes së problemeve globale, si: ndotja e mjedisit, ruajtja e burimeve natyrore etj. në vendin tonë;</li> <li>të analizojnë shkaqet dhe pasojat që sjellin këto probleme në bashkësinë e tyre, në Shqipëri dhe më gjerë;</li> <li>të vlerësojnë në mënyrë kritike qëndrimet e politikës së vendit tonë ndaj problemeve globale: <ul style="list-style-type: none"> <li>të identifikojnë disa nga problemet globale që ndeshen në lagjen, bashkësinë ose në vendin e</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndotje mjedisi</li> <li>Ruajtje e burimeve natyrore</li> <li>Varfëri</li> <li>Zhvillim i qëndrueshëm</li> <li>Të drejta etj.</li> </ul>

	<p>tij;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ të identifikojnë disa nga politikat e ndërmarra për të zgjidhur problemin nga: <ul style="list-style-type: none"> <li>– pushteti lokal,</li> <li>– shteti,</li> <li>– organizata joqeveritare.</li> </ul> </li> <li>● të demonstrojnë aftësi qytetare për të ndërmarrë veprime konkrete në të mirë të përmirësimit të situatës mjedisore në komunitet.</li> </ul>	
--	--	--

**KLASA 9**  
**35 javë x 1 orë/javë = 35 orë**

<p><b>LINJA: Ç’ ËSHTË DEMOKRACIA?</b></p> <p><b>Orë të sugjeruara: 8 orë</b></p>		
<p><b>Përshkrimi i linjës:</b> Kjo linjë synon të aftësojë nxënësit në njohjen e konceptit të demokracisë, të përkufizimeve të ndryshme të saj dhe ta aftësojë atë të zbatojë këto njohuri në vendimmarrjet e jetës së tij të përditshme. Duke njohur karakteristikat kryesore të demokracisë, nxënësi njihet me një listë kriteresh mbi bazën e të cilave ai vlerëson sjelljet, qëndrimet, praktikat e politikat demokratike e jodemokratike dhe përcakton qëndrimin e tij në raport me realitetin në të cilin jeton, duke filluar nga familja, shkolla, lagjja e më gjerë.</p>		
<b>Linja</b>	<b>Objektivat</b>	<b>Konceptet kyçe</b>
<b>Ç’është demokracia?</b>	<b>Gjatë realizimit të kësaj linje, nxënësit duhet të aftësohen:</b>	



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të dallojnë konceptet e ndryshme për demokracinë dhe të japin përkufizimin e tyre për demokracinë;</li> <li>• të dallojnë demokracinë e drejtpërdrejtë nga demokracia e përfaqësuar dhe të listojnë karakteristikat kryesore të tyre;</li> <li>• të dallojnë argumentet që mbështesin nga ata që i kundërvihen demokracisë;</li> <li>• të mbajnë dhe të shprehin qëndrimin e tyre ndaj demokracisë dhe tipareve të saj;</li> <li>• të vlerësojnë nëse mendimet dhe sjelljet e tyre janë pro apo kundër demokracisë;</li> <li>• të eksplorojnë dhe të vlerësojnë elemente dhe praktikatat e demokracisë në bashkësinë ku jetojnë, në shtëpi, në klasë, në lagje dhe në realitetin shqiptar;</li> <li>• të parashikojnë dukuri të ndryshme në fusha të ndryshme të jetës (në familje, në shkollë, në lagje etj.), duke u nisur nga praktikatat dhe prirjet aktuale që vihen re në të.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Demokracia</li> <li>• Karakteristikatat e demokracisë</li> <li>• Demokracia e drejtpërdrejtë</li> <li>• Demokracia e përfaqësuar</li> <li>• Kushtet e demokracisë</li> <li>• Elemente të demokracisë</li> <li>• Praktikatat e demokracisë</li> </ul>
<p><b>LINJA: FAKTORËT QË NDIHMOJNË DHE PENGOJNË DEMOKRACINË</b></p> <p><b>Orë të sugjeruara: 6 orë</b></p>		
<p><b>Përshkrimi i linjës:</b> Kjo linjë synon të mundësojë aftësimin e nxënësve në njohjen e faktorëve kryesorë që mbështesin dhe të atyre që pengojnë demokracinë.</p> <p>Nxënësit, përmes kësaj linje njihen me disa prej karakteristikave dhe prirjeve individuale që, të vëna në zbatim, mund të mbështesin apo mund të pengojnë demokracinë. Në këtë mënyrë, ata aftësohen të gjykojnë veten dhe të tjerët në raport jo vetëm me përgjegjësinë e tyre qytetare, por edhe në raport me aftësitë që kërkohen për të qenë pjesëmarrës të kualifikuar në ndërtimin e demokracisë dhe të atyre që kërkohen për ta mbrojtur e konsoliduar atë.</p>		
<b>Linja</b>	<b>Objektivat</b>	<b>Koncepte kyçe</b>

<p><b>Faktorët që ndihmojnë dhe pengojnë demokracinë</b></p>	<p><b>Gjatë realizimit të kësaj linje, nxënësit duhet të aftësohen:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përcaktojnë disa nga faktorët që mbështesin dhe të atyre që pengojnë demokracinë;</li> <li>• të identifikojnë faktorë që mbështetin dhe pengojnë demokracinë në klasë, shkollë, lagje, vend;</li> <li>• të identifikojnë faktorët që ushqejnë lindjen dhe veprimin e faktorëve që mbështesin dhe të atyre që rrezikojnë demokracinë në Shqipëri;</li> <li>• të japin një përcaktim lidhur me tiparet e realitetit në Shqipëri që mund të rrezikojnë demokracinë;</li> <li>• të diskutojnë për mundësinë e zvogëlimit të veprimit të faktorëve që rrezikojnë demokracinë në Shqipëri.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Faktorë që mbështesin demokracinë</li> <li>• Faktorë që pengojnë demokracinë</li> <li>• Karakteristika individuale</li> <li>• Karakteristika shoqërore</li> </ul>
<p><b>LINJA: FUNKSIONIMI I DEMOKRACISË</b></p> <p><i>Orë të sugjeruara: 13 orë</i></p>		
<p><b>Përshkrimi i linjës:</b></p> <p>Kjo linjë e mundëson nxënësin të njihet me elementet kryesore të funksionimit të demokracisë, me detyrat që zgjidh, mund të zgjidhë dhe me ato që nuk mund t'i zgjidhë në një kohë dhe hapësirë të dhënë.</p> <p>Në këtë linjë, nxënësi njihet me rolin e institucioneve demokratike, me funksionet kryesore të pushtetit dhe rëndësinë e funksionimit të tyre të pavarur si kusht për të minimizuar abuzimet e pushtetit etj.</p> <p>Po kështu, në këtë linjë nxënësi mëson të gjithë faktorët që realizojnë funksionimin e demokracisë, që nga përfaqësimi i individëve në parti, identifikimi i interesave të përbashkëta që mundësojnë këtë përfaqësim, pjesëmarrja në zgjedhje e votime etj., etj.</p> <p>Në këtë mënyrë ai fiton të gjithë aftësitë intelektuale e politike të domosdoshme për një pjesëmarrje të vetëdijshme e të kualifikuar në jetën e proceset demokratike në bashkësinë ku jeton, në shkollë, lagje e më gjerë.</p>		
<p><b>Linjat / nënlinjat</b></p>	<p><b>Objektivat</b></p>	<p><b>Koncepte kyçe</b></p>

<p><b>Funksionimi i demokracisë</b></p>	<p><b>Gjatë realizimit të kësaj linje, nxënësit duhet të aftësohen:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajnë disa nga çështjet që duhet të zgjidhë demokracia në përgjithësi dhe demokracia shqiptare në mënyrë të veçantë;</li> <li>• të eksplorojnë çështje që janë parësore për t'u zgjidhur në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë;</li> <li>• të përshkruajnë rolin e institucioneve demokratike;</li> <li>• të vlerësojnë veprimtarinë e institucioneve në Shqipëri duke i krahasuar me qëllimet dhe vlerat e demokracisë;</li> <li>• të tregojnë çfarë duhet të përmirësohet në veprimtarinë e shkollës (të lagjes etj.) nga pikëpamja e qeverisjes demokratike të saj;</li> <li>• të përshkruajnë strukturën e qeverisjes në një demokraci dhe detyrat kryesore të tri degëve të pushtetit;</li> <li>• të dallojnë elemente demokratike ose jodemokratike në funksionimin e pushtetit dhe të degëve të ndryshme të tij në Shqipëri;</li> <li>• të identifikojnë faktorë të ndryshëm ekonomikë, shoqërorë, politikë etj., që ndikojnë në cilësinë e funksionimit të pushtetit demokratik në Shqipëri;</li> <li>• të tregojnë cili duhet të jetë roli i individëve në demokraci dhe të gjykojnë për rolin e individëve në shoqërinë shqiptare në drejtim të zhvillimit ose pengimit të proceseve demokratike;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Funksionimi i demokracisë</li> <li>• Çështje të demokracisë</li> <li>• Institucion</li> <li>• Roli i institucionit</li> <li>• Kritere të demokracisë</li> <li>• Struktura e qeverisjes</li> <li>• Funksion legjislativ</li> <li>• Funksion ekzekutiv;</li> <li>• Funksion gjyqësor</li> <li>• Roli i individit</li> <li>• Diskutimet</li> <li>• Debati publik</li> <li>• Vendimmarrjet</li> <li>• Partitë politike</li> <li>• Zgjedhjet</li> <li>• Përfaqësim</li> <li>• Kandidatët</li> <li>• Votimi</li> </ul>
---	---	---

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajnë rolin e partive politike në demokraci dhe marrëdhëniet e tyre me interesat e individëve që organizohen në parti;</li> <li>• të përshkruajnë rolin e zgjedhjeve dhe të votimit në një demokraci;</li> <li>• të diskutojnë për rëndësinë e zbatimit të procedurave të drejta të votimit;</li> <li>• të diskutojnë për rëndësinë e tolerancës politike dhe të pranimit të rezultateve të zgjedhjeve (dhe të humbjes së zgjedhjeve) demokratike në një demokraci;</li> <li>• të diskutojnë për karakterin demokratik të zgjedhjeve në Shqipëri, gjatë viteve të fundit;</li> <li>• të organizojnë vetë zgjedhjet e qeverisë së nxënësve në klasën dhe në shkollën e tyre, duke mbajtur parasysh qëllimet e qeverisë së nxënësve, cilësinë e përfaqësuesve, procedurat e zgjedhjes dhe të votimit demokratik etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Procedura votimi</li> </ul>
<p><b>LINJA. PJESËMARRJA QYTETARE</b></p> <p><b>Orë të sugjeruara: 8 orë</b></p>		
<p><b>Përshkrimi i linjës:</b> Kjo linjë ka të bëjë me qëllimin final të edukimit qytetar e politik, pikërisht me pjesëmarrjen e nxënësit në jetën publike e politike të bashkësisë ku jeton.</p>		
<b>Linja</b>	<b>Objektivat</b>	<b>Koncepte kyçe</b>

<p><b>Pjesëmarrja qytetare</b> <b>(6 orë)</b></p>	<p><b>Gjatë realizimit të kësaj linje, nxënësit duhet të aftësohen:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të diskutojnë për rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në demokraci,</li> <li>• të diskutojnë për rëndësinë që ka të qenit qytetar i informuar për cilësinë e pjesëmarrjes qytetare,</li> <li>• të përshkruajnë disa nga rrugët e realizimit të pjesëmarrjes qytetare në demokraci,</li> <li>• të diskutojnë për mundësitë dhe rrugët e rritjes së pjesëmarrjes qytetare në realitetin ku jetojnë (lagje, shkollë, fshat, qytet etj.),</li> <li>• të identifikojnë probleme për zgjidhje në mjedisin ku jetojnë dhe të formulojnë e të paraqesin politikën publike për zgjidhjen e tyre.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgjegjësi qytetare</li> <li>• Pjesëmarrje qytetare</li> <li>• Informim</li> <li>• Gjykim kritik</li> <li>• Dëgjim aktiv dhe krijues</li> <li>• Interes publik</li> <li>• Politikë publike</li> <li>• Protestë</li> <li>• Demonstratë</li> <li>• Probleme vendore</li> <li>• Problem kombëtar</li> </ul>
---	---	--